



**Thirrje publike për ofertim – zhvillimi i një produksioni audio/video  
për materializimin vizual të krijimtarisë tradicionale zejtare në kuadër të projektit  
“Rrënjët e mia-Kulturë 360”**

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare fton kompanitë e produksioneve multimediale të ofertojnë për produksionin e një audio/video e cilat do të materializojnë vizualisht tërësinë e krijimtarisë tradicionale zejtare shqiptare në zbatim të projektit “Rrënjët e mia-kulturë 360” i cili bashkëfinancohet me Ministrinë e Kulturës.

Nëpërmjet paraqitjes estetike të objekteve dhe teknikave të zejtarisë, Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare synon të mundësojë promovimin e traditës së pasur origjinale dhe me vlera të çmuara të artizanatit e përhapur në çdo krahinë të Shqipërisë, e krijuar dhe trashëguar ndër shekuj nga mjeshtrit popullorë jo vetëm brenda vendit por edhe atë pjesë të mbartur dhe kultivuar nga diaspora.

**Shërbimi i kërkuar:**

Nga kompania ofertuese kërkohet specifikisht:

1. Video prodhim - xhirime, toni/zëri, montazhi, ndriçimi, dizajnimet e videos (ALL/min)
2. Audio lexim/narracion – inçizim
3. Kohëzgjatja jo më shumë se 5 minuta

**Kushtet për Shërbimin:**

Pas nënshkrimit të kontratës, ofruesi i shërbimeve pritet që:

1. Të jetë në gjendje t’i respektojë me përpikmëri afatet kohore për prodhimet audio/video/dizajn.
2. Të jetë në gjendje që të punojë shpejtë dhe të dorëzojë video/audio/dizajn të cilësisë së lartë HD.
3. Të jetë i hapur për rishikime dhe përmirësime përgjatë procesit të produksionit.

**Për t’u kualifikuar, kompania duhet:**

- Të jetë e regjistruar si subjekt ekonomik në Republikën e Shqipërisë
- Të ofrojë dëshmi të përvojës, referencave dhe portofolit të punëve të mëparshme të audio/video produksioneve/dizajnit.

**Kriteret e pjesëmarrjes:**

Të gjitha kompanitë e interesuara duhet të depozitojnë dokumentacionin e kërkuar në adresën: [info@adbc.al](mailto:info@adbc.al) deri në dt. 3 maj 2021, ora 16:00.

Profilin e kompanisë dhe portofolin

Dokumente ligjore që vërtetojnë se kompania është entitet i regjistruar në Republikën e Shqipërisë. Oferta financiare/çmimi duhet të bëhet për njësi ALL/min video produksion me TVSH.